



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Tiranë më 16.10.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

Mbi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”

Drejtuar: Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Komisioni për Sigurinë Kombëtare në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 15.10.2018, miratoi në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Pjerin Ndreu.

I - QËLLIMI I PROJEKT – AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN:

Projektligji propozon ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016.

Alokimet e vitit 2016, për këtë program, financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA) me një buxhet total, për të dyja vendet, prej 1 411 765 euro (bashkëfinancimi kombëtar i shteteve 180 000 euro, kontributi i BE-së 1 200 000 euro). Sqarojmë se, në total, kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Shqipëri-Kosovë,

për periudhën 2014-2020, arrin vlerën 8 400 000 euro, por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Zona e programit ku do të zbatohen projektet mbulon një territor prej 8 335 km², me një popullsi që arrin në rreth 936 761 banorë, nga të cilët 76% jetojnë në territorin e Kosovës dhe 24% në anën shqiptare të zonës së programit. Në Shqipëri, zonat përfituese përfshijnë rajonet e Kukësit dhe të Lezhës (8 bashki, me një total prej 362 vendbanimesh), ndërsa në Kosovë, përfshijnë Rajonin Ekonomik Perëndimor dhe Rajonin Ekonomik Jugor (12 bashki).

Programi do të fokusohet në këto prioritetet tematike:

1. Mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i riskut;
2. Turizmi dhe trashëgimia natyrore e kulturore;
3. Rinia dhe arsimi, me fokus nxitjen e punësimit.

Shqipëria dhe Kosova do të bashkëpunojnë ngushtë me Delegacionin e BE-së në Tiranë për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Struktura institucionale e programit është e përbërë nga autoriteti kontraktues i programit (DBE në Tiranë), Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, Sekretariati i Përbashkët Teknik si dhe koordinatorët kombëtarë të fondeve IPA të dyja vendeve përfituese.

II - PËRFUNDIME

Anëtarët e komisionit pas pyetjeve të adresuara përfaqësueses së Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, sugjeruan që në programin IPA III, përveçse të bëhet konsultimi me Ministrinë e Brendshme si ministri përgjegjëse për pikat e kalimit kufitar, një nga prioritetet të jetë edhe ndërhyrja në infrastrukturën e tyre.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare me shumicën e anëtarëve të pranishëm miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi .

Relator

Pjerin NDREU

Kryetare

Ermonela (FELAJ) VALIKAJ